



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 0491/1 Prot.

Tiranë, më: 24/2/2025

URDHËR

Nr. 85, Datë 24.2.2025

PËR
NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TE INTERESAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “b”, pika 2, e nenit 41 dhe pika 3, e nenit 42, të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
2. Caktimi i anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave:
 - znj. Inxhi Buzi, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 - znj. Dorina Hoxha, Specialist i burimeve njerëzore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit;
 - znj. Erinda Fejzulla, Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore.
3. Autoriteti Përgjegjës të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave.
4. Urdhri i Ministrit nr. 374, datë 8.11.2019 “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ky Urdhër t’i njoftohet zyrtarisht ILDKPKI-së.
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Autoriteti Përgjegjës në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI